



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT MAT

VENDIM

Nr. 7 , datë 19/05/2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES
“KËRKESË PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË
LEJES/AUTORIZIMIT”, Z.ISMAIL SELMANI

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare (Bar-Restorant) me Nr.serie:00003, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.33, datë 22.02.2017, z.Ismail Selmani, me vendndodhje, Bashkia Milot, Qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- X=472911.2
- Y=4614911.4

- Z=40 m.m.n.d

- Prurja mesatare : $Q_{mes} = 1 \text{ l/s}$
- Sasia e ujit në përdorim : $Q = 0,13 \text{ l/s}$
- Qëllimi i përdorimit : Ujë sanitar (Bar-Restorant)
- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

